



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 1496/2026
Data: 10.02.2026

PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e parë – I – për vitin 2026 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 20.01.2026, me fillim pune në ora 11:00, në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetar i Komunës), **Ali Axhami** (Udhëheqës për Buxhet dhe Financa), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim), **Kimete Kuka-Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Senad Kalisi** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Betime Dernjani** (Zyrtare e Personelit), **Vjosa Rogaçi** (Zyrtare për Barazi Gjinore), **Bashkim Sopa** (Zyrtar për Transparencë).

RENDI I PUNËS

1. Plani i punës së ekzekutivit të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2026.
2. Raporti financiar për vitin 2025.
3. Plani i punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2026.
4. Propozim-vendim në parim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme.
5. Propozim-vendim për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës.
6. Propozim-vendim për formimin e komisionit të ankesave të palëve në procedurat e dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës.
7. Propozim-vendim për përbërjen e komisionit komunal të aksionarëve të NPL Pastrimi.
8. Informatë mbi veprimtaritë e subjekteve afariste për vitin 2025.
9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson: për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka, e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATU RENDI I PUNËS

1. Plani i punës së ekzekutivit të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2026

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevdi Dernjani thekson: plani i punës së kryetarit të komunës për vitin 2026 bazohet në kërkesat e qytetarëve, të cilat janë bërë gjatë vitit 2025 në dëgjimet buxhetore dhe kanë të bëjnë me vitin 2026. Në këtë plan janë përfshirë gjithsej nëntë drejtori, zyra e prokurimit, zyra ligjore, zyra për barazi gjinore dhe zyra e informimit. Nëse keni ndonjë propozim apo sugjerim, mund të parashtroni.

Menduh Vlasi thekson: unë mundem me përgëzuar ekzekutivin për këtë punë voluminoze që na keni lodhur duke lexuar, por, nëse analizohet në thellësi, edhe me gjysmën e fletave keni mundur me i përfshirë. Një pjesë e madhe e drejtorive i kanë përshkruar punët dhe detyrat, të cilat rrjedhin nga ligji dhe statuti, që mendoj se nuk ka pasur nevojë. Në plan të punës më intereson se cilat punë ka me i kryer drejtoria dhe, në fund, kur të jepet raport, të shënohen se sa i ka realizuar ato punë. Te disa drejtori është mirë, ndërsa te disa pjesa dërmuese është përshkrim i detyrave që i përshkruhen në ligj dhe në statut. Vërejtjet që jepen në KPF a përmirësohen në material kur të përcillet për Kuvend apo përcillen në këtë formë. Nëse përmirësohen, ne do të japim vërejtje dhe ato vërejtje që mendoni se janë me vend përfshini, ndërsa ato që i mendoni se nuk janë me vend mos i përfshini.

Kryesuesi thekson: kjo është mbledhje e KPF-së dhe, nëse ka rekomandime dhe gabime, përmirësohen në mënyrë që në Kuvend të jetë më serioz, se mundet ndoshta dikush edhe me gabuar dhe diçka që duhet të përmirësohet drejtoritë përkatëse e përmirësojnë.

Menduh Vlasi thekson: rastësisht hyra në uebfaqe të Komunës; dy drejtori e kanë publikuar planin e punës, mirëpo publikimi i planit të punës bëhet pasi të kryhet mbledhja e Kuvendit të Komunës. Një pjesë e madhe e drejtorive vetëm sipërfaqësisht i kanë paraqitur se “kemi me bërë këtë, kemi me bërë këtë”, por nuk tregohet se kur kanë me i kryer, apo vetëm shënohet janar-dhjetor. Në asnjë drejtori nuk e pashë që do të miratojnë ndonjë rregullore gjatë këtij viti, por, sa e di unë, që me ligj rregullorja për taksa dhe tarifa për çdo vit duhet ta kalojë procedurën e shqyrtimit dhe është mirë që me proceduar për Kuvend dhe me përcaktuar se në cilin muaj.

Sevdi Dernjani thekson: planet që janë publikuar para se me u miratuar në Kuvend, sigurisht që do të ndryshohen. Duhet të keni parasysh që plani i punës është për vitin 2026, që bazohet në planifikimet buxhetore të vitit 2025.

Medina Imishti thekson: te objektivat për vitin 2026 nuk e pashë që ishte sheshi i qytetit, që kisha dashur me ditë se a është projekt që ka me u realizuar në vitin 2026. Si mendon me implementuar mjekësinë familjare? E pashë një pjesë te kontrolli i brendshëm, marrja e masave ndaj stafit. Planifikimi kohor për vizitat shtëpiake ke me një afat të caktuar, por çka nënkupton, sepse vizitat shtëpiake janë sipas nevojës, që kanë një plan kohor që duhet me u realizuar.

Majlinda Kaloshi thekson: sheshi i qytetit është në objektivat tona; te objektivi numër dy, zhvillimi i pikave me potencial ekonomik dhe turistik, është paraparë edhe ndërtimi i sheshit të qytetit.

Kimete Kuka-Hasallari thekson: sa i përket implementimit të mjekësisë familjare, jemi duke u munduar me atë staf të cilin e kemi me i kryer punët sipas udhëzimeve. Sa i përket masave disiplinore, parashihen përmes stafit të QKMF-së, nëse ka shkelje, sepse janë disa komisione që duhet të ndërmarrin masa nëse nuk ka disiplinë në punë apo shkelje brenda stafit të QKMF-së, ku realisht ky plan ka ardhur prej stafit të QKMF-së dhe sipas tyre është planifikuar edhe pjesa kohore e tyre. Për vizitat shtëpiake kanë potencuar që vazhdimisht jemi në teren dhe për çdo pacient që ka nevojë jemi afër qytetarit, kështu që do t'i kem parasysh që me i përmirësuar çështjen e kohës së planifikimit të vizitave, për shkak se nuk ka nevojë të ceket se vazhdimisht jemi në teren.

Medina Imishti thekson: marrja e masave a ka qenë në planin tanë edhe në mandatin e kaluar?

Kimete Kuka-Hasallari thekson: në planin tim personal nuk ka qenë, por është plan i QKMF-së që është planifikuar.

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA PLANI I PUNËS SË EKZEKUTIVIT TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2026 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

2. Raporti financiar për vitin 2025.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Ali Axhami thekson: materialin e keni pranuar me kohë dhe nuk kam diçka me diskutuar.

Menduh Vlasi thekson: jam munduar me analizuar këtë raport financiarë, por nëse nuk e kam llogaritur gabim, ka vazhduar trendi i viteve të kaluara me mbetje të buxhetit suficit, me buxhet të pashpenzuar dhe në këtë vit ka shkuar pak më shumë. Nëse nuk gaboja janë 456 000 € që janë të pashpenzuara. Do ta diskutojmë edhe në mbledhje të kuvendit të komunës dhe propozoj që për mbledhje të kuvendit të komunës t'i shtohet edhe një rubrikë poshtë, që me qenë në përqindje sa është realizuar dhe sa nuk është realizuar. Faqe 15 dhe 16, te rubrika e fundit, nuk vërehen krahasimet.

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI FINANCIAR PËR VITIN 2025 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND.

3. Plani i punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2026.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevdi Dernjani thekson: ky plan synon rritjen e sigurisë dhe parandalimin e rreziqeve në jetën e përditshme të qytetarëve. Plani bazohet në bashkëpunim të drejtpërdrejtë ndërmjet institucioneve dhe komunitetit për të krijuar një bashkëpunim të drejtë për drejtë, për të krijuar një komunitet sa më të sigurtë. Ky plan përfshinë sigurinë në shkollë, sigurinë në komunikacion dhe çështje tjera me radhë.

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PLANI I PUNËS SË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2026 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Propozim vendim në parim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson: kemi paraparë me i dhënë në shfrytëzim afatgjatë katër parcele, të cilat janë në pronësi të komunës. Dy parcele janë në fshatin Pustenik dhe dy parcele në fshatin Rezhancë. Të dhënat për këto parcele i keni. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatgjatë është ngritja e zhvillimit të aktivitetit bujqësorë në zonat rurale. Por qëllimi më i rëndësishëm është se te vlerësimi i performancës së komunës rregullisht është një pyetje standarde për shfrytëzim afatgjatë të pronave, e ne çdo herë jemi poentuar me zero poena për shkak se nuk kemi pasur kesi lloj planifikimi. Sa i përket procedurave, paraprakisht shpallet lista e veçantë e pronave të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim afatgjatë. Ajo listë publikohet në vebfaqe të komunës, pastaj kuvendi i komunës miraton vendimin paraprakë, mbahet ankandi publik, formohet komisioni për vlerësimin e ofertave dhe një komision për ankesa. Komisioni për vlerësimin e ofertave përpilon një raport dhe ia kthen kuvendit për miratim dhe nëse kuvendi e miraton, e obligon Kryetarin me nënshkruar kontratë me palën më të favorshme. Nëse ka ndonjë pyetje, mund të parashtroni.

Menduh Vlasi thekson: në parim jam për dhënien e këtyre pronave, por së pari kam pyetje se a janë prona komunale apo jo. Por jam habitur se pse kjo nguti, propozim vendim për me dhënë, propozim vendim për me formuar komisionin, pastaj komisionin për ankesa. Së pari kisha propozuar vetëm një propozim vendim për dhënien në shfrytëzim, ndërsa në mbledhjen tjetër me formuar komisionin, edhe pse nuk prishë punë, por nuk pe di pse kjo nguti shumë e madhe. Kërkoj nga ekzekutivi të na i sjell hartën që ta dimë na se ku janë ato prona. Nëse janë prona që i ka shfrytëzuar komuniteti, unë nuk jam për, sepse edhe në kohën e Turqisë çdo fshat ka pasur pronë të përbashkët publike, ku i kanë kullotur bagëtinë, ku kanë bërë lojëra. Nëse si kuvend e japim atë pronë, të cilën nuk e di ku është, fshati më nuk mund ta shfrytëzon, por e shfrytëzon një person për interes të një personi, që jam për se mund të bënë një zhvillim të biznesit. Komisioni duhet të del dhe të bisedon me komunitetin e Rezhancës dhe Pustenikut se a pajtohen ata me ia dhënë dikujt apo jo. Nëse nuk pajtohen, unë do të jem kundër.

Nexhmedin Daci thekson: këto figurojë si prona të kuvendit komunal dhe nuk kemi arsye me i pyetur personat se me dhënë apo jo, se a ju vynë juve, për shkak se nëse dikush e shfrytëzon, e shfrytëzon pa leje, që donë të thotë pa marrëveshje me komunën. Ky vendim, nëse miratohet, publikohet në vebfaqe të komunës dhe qytetarët mundën me parashtruar ankesë. Formimi i komisionit për vlerësim të ofertave ndërlihet me dhënien në shfrytëzim, sepse procedurat nuk janë të shkurta. Një herë me miratuar, pastaj na me prituri edhe një mbledhje të kuvendit, na shkon viti. Nëse paraqitet dikush edhe pa pagesë, ia kisha dhënë, se kurrfarë interesi komuna nuk ka, për shkak se njerëzit nuk janë duke e punuar pronën e vetë, mirëpo këtë e tregon ankandi.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin. Nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PROPOZIM VENDIMI NË PARIM PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONAVE TË PALUAJTSHME QË TË PËRCILLET PËR KUVEND.

5. Propozim vendim për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson: formimi i komisionit është i paraparë me ligj, duhet të jenë pesë anëtarë të komisionit, prej tyre dy janë përfaqësues nga ekzekutivi i komunës, dy nga kuvendi i komunës dhe një nga organizatat joqeveritare.

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PROPOZIM VENDIMI PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE DHE VLERËSIMIN E OFERTAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS QË TË PËRCILLET PËR KUVEND.

6. Propozim vendim për formimin e komisionit të ankesave të palëve në procedurat e dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës.

Kryesuesi thekson: - për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson: edhe formimi i komisionit është i paraparë me ligj. Edhe në këtë komision, dy anëtarë duhet të jenë prej kuvendit, dy prej ekzekutivit të komunës dhe një nga organizatat joqeveritare.

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PROPOZIM VENDIMI PËR FORMIMIN E KOMISIONIT TË ANKESAVE TË PALËVE NË PROCEDURAT E DHËNIES NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS QË TË PËRCILLET PËR KUVEND.

7. Propozim vendim për përbërjen e komisionit komunal të aksionarëve të NPL Pastrimi.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlashi thekson: te propozim vendimi kërkoj që çdo herë që anëtarët e ekzekutivit dhe të shoqërisë civile të shënohen me mbetur vetëm të kuvendit.

Medina Imishti thekson: në propozim vendim shënohet që një anëtarë nga ekzekutivi i komunës, a hyjnë edhe shërbyesit civil për shkak se ligji nuk e përcakton.

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PROPOZIM VENDIMI PËR PËRBËRJEN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE TË NPL PASTRIMI QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

8. Informatë mbi veprimtaritë e subjekteve afariste për vitin 2025.

Kryesuesi thekson: - për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Majlinda Kaloshi thekson: Drejtoria, në kuadër të saj, ka edhe Qendrën për Regjistrim të Bizneseve, e cila kryen të gjitha shërbimet sa i përket bizneseve lokale. Sipas statistikave që Drejtoria ka, në Qendrën për Regjistrim të Bizneseve që nga fillimet e saj e deri më tani janë të regjistruar 436 biznese, nga ku: 255 prej tyre i takojnë atyre Individuale (B.I), 180 biznese SHPK dhe 1 biznes SHA. Në Han të Elezit, nga bizneset e regjistruara dhe sipas të dhënave në ARBK, kemi paraqitur një grafikë e cila paraqet një analizë sipas sektorëve ekonomik në përqindje. Këto kategori përfshijnë: Tregtinë (20%), Aktivitete shërbyese (16%), Transporti (18%), Ndërtimtaria (6%), Të tjera (40%). Në material është përfshirë edhe sektori i taksave sipas ligjit në fuqi, që për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2025 kemi inkasuar 75,485.00 €.

Visar Hasallari thekson: sa persona janë të shuarja e bizneseve dhe në cilën lloj të kategorisë bëjnë pjesë këto biznese që janë shuar.

Majlinda Kaloshi thekson: - për mbledhje të kuvendit do t'ua japë këtë përgjigje.

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU INFORMATA MBI VEPRIMTARITË E SUBJEKTEVE AFARISTE PËR VITIN 2025 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson: a keni ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka, e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në ora 11:40.

Procesmbajtësi
Avni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta